



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 78/5 Prot.

Tiranë, më 06.04.2017

**V E N D I M**

Nr.73, datë 06/04/2017

***"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 148, datë 25.11.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga institucioni i Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 01.09.2016 e në vazhdim"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 148, datë 25.11.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave", në institucionin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës,

**VËREJ SE:**

Me vendimin nr. 138, datë 30.12.2015 "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", është urdhëruar të fillojë mbikëqyrja e përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës. Bazuar në këtë vendim ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 148, datë 25.11.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit

*dhe Akuakulturës, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.*

2. *Institucioni i mbikëqyrur, në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Departamentin e Administratës Publike, në momentin e rishikimit të strukturës, duhet të parashikojnë në këtë strukturë, një pozicion pune për t'u kujdesur për veprimtarinë e përditshme të burimeve njerëzore të institucionit.*
3. *Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore të institucionit, në zbatim të kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, të vijojë procesin si më poshtë:*
  - *Të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës në momentin e dokumentimit të tyre, duke depozituar një kopje pranë Departamentit të Administratës Publike.*
  - *Të administrojë në dosjet individuale të punonjësve \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , aktet që vërtetojnë plotësimin e kriterit të nivelit të diplomës “Master Profesional”, sipas orientimeve në Raportin Përfundimtar të mbikëqyrjes.*
  - *Të nënshkruhen formularët e përshkrimit të punës në rastet e nëpunësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , dhe më pas, kjo kopje e aktit të vendoset në dosjen individuale të personelit.*
4. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr. 148, datë 25.11.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, prej datës 01.09.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, me Vendimin nr. 11, datë 07.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 148, datë 25.11.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga institucioni i Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 01.09.2016 e në vazhdim”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.148, datë 07.02.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës”.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 78/2 prot., datë 07.02.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Bazuar në procesverbalin e mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe nënshkruar edhe nga personat e kontaktit të institucionit të Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, dhe pas shqyrtimit të materialeve shkresore të administruara në përfundim të procesit të verifikimit, rezultoi sa më poshtë vijon:

Në zbatim të pikës 2 të Vendimit u konstatua se institucioni i mbikëqyrur i ka dërguar në mënyrë elektronike, në datën 20.12.2016, njësisë së burimeve njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave propozimin për shtimin e 1 pozicioni pune “*specialist i burimeve njerëzore*” në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Nga këqyrja e akteve rezultoi se ky propozim nuk ka gjetur pasqyrim në strukturën që Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave i ka propozuar Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave. Konkretisht, në bazë të një relacioni të hartuar nga njësia e burimeve njerëzore të Ministrisë, me shkresën nr. 10182 prot., datë 28.12.2016, të Ministrit, “*Propozim lidhur me ristrukturimin e Inspektoriatit Shtetëror të Ujërave dhe Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës*”, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike, është dërguar propozimi për shtimin e dy pozicioneve: “*Specialist*” dhe “*Specialist Arkiv-Protokoll*”, në Sektorin e Analizës Ekonomike dhe Buxhetimit.

Në strukturën aktuale Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist. Në strukturën e propozuar, në këtë sektor i cili është emërtuar sektori i Analizës Ekonomike dhe Buxhetimit është parashikuar 1 pozicion përgjegjës sektori 1 pozicion specialist finance, 1 pozicion specialist dhe 1 pozicion specialist arkiv-protokoll. Aktualisht, struktura e propozuar nuk është miratuar ende.

Gjatë verifikimit në subjekt, u konstatua se në zbatim të pikës 3 të rekomandimit të vendimit të Komisionerit:

- Ka përfunduar procesi i hartimit të përshkrimeve të punës nga strukturat përgjegjëse, pjesëmarrëse në këtë proces, duke depozituar një kopje të tyre në Departamentin e Administratës Publike me shkresën nr. 51 prot., datë 06.02.2017 “*Dërgim dokumentacioni*”.
- Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore të institucionit ka administruar në dosjet individuale të punonjësve \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, të cilët nuk plotësonin kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, aktet që vërtetojnë plotësimin e kriterit arsimor. Për punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, vazhdon e njëjta situatë e konstatuar në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ku është evidentuar fakti se në përshkrimet e punës të hartuara nga institucioni, për pozicionet e mbajtura nga këta punonjës (*pozicione të kategorisë ekzekutive, klasa IV/2, niveli B*) kërkohet niveli i diplomës “*Master Profesional*”. Ndërkohë, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucione të administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, tek Lidhja 2, bashkëlidhur këtij vendimi, tek kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit është përcaktuar diploma “*Bachelor*”.
- Janë nënshkruar formularët e përshkrimit të punës në rastet e nëpunësve \*\*\*\*\*, në pozicionin specialist finance dhe \*\*\*\*\* në pozicionin specialist i Sektorit të Monitorimit dhe Kontrollit të Peshkimit (për Vlorën) dhe janë depozituar në dosjen e personelit.

Për sa u përket më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 148 datë 25.11.2016, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës*”, të Komisionerit, rezultoi se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të

institucionit të Prefektit janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

Në përfundim të procesit të verifikimit në subjekt, lidhur me ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, prej datës 01.09.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, rezultoi se aktet e emërimeve në pozicionet e shërbimit civil janë nxjerrë nga njësia përgjegjëse, DAP, sipas parashikimeve të pikës 19, të kreut IV dhe pikës 22 të kreut VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe 34 të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit nr. 148 datë 25.11.2016 në institucionin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 148 datë 25.11.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës”*.
3. Konstatimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative, të kryera gjatë procesit të emërimeve nga institucioni i Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, prej datës 01.09.2016 e në vazhdim.
4. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**